



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA TIRANË**

Nr. 38282/prot.

Tiranë, më 7.10.24

**UNIVERSITETI I TIRANËS**



Nr. 1790/<sub>1</sub> prot.

Tiranë, më 7.10.2024

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

### NDËRMJET

### UNIVERSITETIT TË TIRANËS

### DHE

### BASHKISË TIRANË

Sot, më datë 7.10.2024 lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi midis palëve:

1. **Bashkia Tiranë**, me adresë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 1, 1001, Tiranë, Përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliaj, quajtur këtu e në vijim si "Bashkia";

dhe

2. **Universiteti i Tiranës**, me adresë Sheshi "Nënë Tereza", Rektorati UT-së , përfaqësuar nga Prof. Dr. Artan Hoxha, quajtur këtu e në vijim si "Universiteti";

Të quajtura bashkarisht ose veçmas si "Palët".

Duke qenë se:

Palët kanë shprehur vullnetin për ngritjen e urave të bashkëpunimit midis tyre për mundësimin e angazhimeve të përbashkëta në studime, trajnime, seminare, konferenca, procese të vlerësimit të

shërbimeve, standarteve dhe kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve, konsulenca, ekspertizë, si dhe në hartimin e politikave të reja sociale, programeve dhe projekteve të shërbimeve për grupe dhe komunitete në nevojë, palët bien dakort të nënshkruajnë këtë marrëveshje me kushte si më poshtë vijon:

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit dhe njohja e ndërsjellë, ngritja dhe zhvillimi i mëtejshëm i njohurive profesionale dhe akademike, ngritja e kapaciteteve të stafit dhe studentëve, si dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në fushat me interes të përbashkët midis palëve.

### **Neni 2 Objekti**

1. Objekti i kësaj marrëveshje është realizimi i një bashkëpunimi si dhe ofrimi i shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë, nga Universiteti i Tiranës për Bashkinë Tiranë.
2. Marrëveshja synon bashkëpunimin midis palëve në drejtim të shkëmbimit të eksperiencave dhe realizimin e projekteve të përbashkëta.

### **Neni 3 Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në:

- a) ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- b) ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- c) ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- ç) ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
- d) Vendimin nr.188, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për ofrimin nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të Shërbimeve, në përputhje me Veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre", i ndryshuar;

### **Neni 4 Angazhimet e palëve**

1. Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë bazuar në frymën e një mirëkuptimi reciprok dhe vullneti pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e angazhimit dhe iniciativave të ndërmarra nga palët.
2. Universiteti merr përsipër të përmbushë detyrimet e përcaktuara në këtë marrëveshje, të cilat janë të lejuara në VKM nr. 188, datë 13.3.2019, "Për ofrimin nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të Shërbimeve, në përputhje me Veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre", i ndryshuar;

3. Për shërbimet e ofruara nga Universiteti, Bashkia do të përmbushë detyrimet sipas parashikimeve të përcaktuara në marrëveshje dhe në VKM nr. 188, datë 13.3.2019, “Për ofrimin nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të Shërbimeve, në përputhje me Veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, i ndryshuar;

4. Në lidhje me përmbledhjen, përpunimin apo transferimin e të dhënave personale gjatë zbatimit të angazhimeve të parashikuara nga kjo marrëveshje, palët marrin përsipër të përmbushin të gjitha detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### **Neni 5**

#### **Personi i kontaktit**

1. Personat e kontaktit do të jenë përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshje, me qëllim realizimin e objektivave duke komunikuar dhe shkëmbyer të dhënat në mënyrë sa më korrekte dhe efektive.

2. Personat e kontaktit për secilën palë, në kuadër të implementimit të kësaj marrëveshje janë:

Për Bashkinë Tiranë:

Z./Znj. Nataçi Shkëmbi

Email: natali.shkemi@tirana.al

Tel: 00355686874948

Për Universitetin:

Z./Znj. Anila Paparisto

Email: anila.paparisto@unitir.edu.al / anila.paparisto@yahoo.com

Tel: 00355672004022

3. Në rast të ndryshimit të njërit prej këtyre personave, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

#### **Neni 6**

#### **Kohëzgjatja**

1. Kjo marrëveshje lidhet për një afat 2 vjeçar duke filluar nga data e nënshkrimit të saj, me të drejtë rinovimi, me dakordësinë paraprake të palëve.

2. Çdonjëra nga palët mund të kërkojë të zgjidhë marrëveshjen duke lajmëruar palën tjetër me shkrim të paktën një muaj përpara datës së zgjidhjes.

#### **Neni 7**

#### **Mosmarrëveshjet**

Kjo marrëveshje interpretohen në kuptimin në të cilin mund të ketë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt bazuar në mirëbesimin ndërmjet palëve.

Çdo mosmarrëveshje, që mund të lindë mes Palëve do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre, në frymën e bashkëpunimit, tolerancës dhe kuadrit të etikës morale si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 8**  
**Dispozita kalimtare**

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë marrëveshje bashkëpunimi për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 6.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
3. Kjo marrëveshje përgatitet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, të hartuar nga palët në vullnet të lirë e të plotë, me të njëjtën përmbajtje dhe formë, 2 (dy) prej të cilave depozitohet në Bashkinë e Tiranës dhe 2 (dy) në Universitetin e Tiranës.
3. Kushtet e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi pranohen dhe nënshkruhen nga të dyja palët.

**Palët nënshkruese**

**PËR**

**BASHKINË TIRANË**

**KRYETARI**

**ERION VELIAJ**



**PËR**

**UNIVERSITETIN E TIRANËS**

**REKTORI**

**PROF. DR. ARTAN HOXHA**

